

Marjan Ndershtiqaj

Drejtor I Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër

Z. Marjan Ndershtiqaj ka lindur në Shkodër, më 21.09.1996. Është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti I Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ku gjatë viteve 2020-2022 ka përfunduar edhe studimet Master Shkencor në “E drejtë Kushtetuese dhe Administrative”. Në vitin 2024 ka fituar titullin Avokat.

Z. Ndershtiqaj për periudhën 2019- 2023 ka qenë anëtar I Këshillit Bashkiak Shkodër, anëtar I Komisionit për çështje ligjore si dhe për shërbimet sociale, strehimit dhe çështjeve gjinore.

Nga viti 2018 deri më 7 Shkurt 2024 ka mbajtur pozicionin Jurist/Specialit për ndryshim pronësie mjete, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër.

Nga muaji Shkurt 2024, z. Ndershtiqaj ushtron detyrën si Drejtor Rajonal në po këtë Drejtori.